



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health*

## **PLANI I VEPRIMIT PËR VAKSINIM TË QYTETARËVE NË MASË ME VAKSINËN KUNDËR COVID-19**

*Maj 2021*

## **Shkurtesat**

BB - Banka Botërore

IKShPK - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

KKK - Kryqi i Kuq i Kosovës

KPSh - Kujdesi Parësor Shëndetësor

KDSh - Kujdesi Dytësor Shëndetësor

KTSh - Kujdesi Tretësor

MSh - Ministria e Shëndetësisë

OBSH - Organizata Botërore e Shëndetësisë

ASHI - Agjencia e Shoqërisë së Informacionit

## PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....
2. QËLLIMI.....
2. METODOLOGJIA.....
3. SFONDI.....
4. OBJEKTIVAT.....
5. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT.....
6. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT.....
7. PLANI I VEPRIMIT.....

## 1. HYRJE

Sëmundja e Koronavirusit (COVID-19) është sëmundje e rrugëve të frymëmarrjes e shkaktuar nga SARS-CoV-2. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) në Janar të vitit 2020, shpalli shpërthimin e sëmundjes së Koronavirusit, si një emergjencë të shëndetit publik me rëndësi ndërkombëtare.

Me qëllim të parandalimit të përhapjes së COVID-19 edhe në Kosovë sikurse në vendet e tjera ka filluar vaksinimi i qytetarëve me vaksinat të cilat janë në dispozicion. Deri më sot, janë vaksinuar 58,486 qytetarë, me 48% të vaksinuar meshkuj, kurse 52% femra. Sa i përket grup-moshave personat e vaksinuar deri më tani janë, moshat mbi 80 vjeç – 7,327 persona, grup-moshat 61-80 janë vaksinuar 38,046 persona, grup- moshat 41-60 vjeç janë vaksinuar 9,326, kurse grup- moshat 21-40 vjeç janë vaksinuar 5,829 persona dhe grup- mosha 0-20 117.

Hartimi dhe miratimi i Planit të veprimit për vaksinim të qytetarëve në masë me vaksinën kundër COVID-19 është në zbatim të masave të veçanta për parandalim konform Nenit 12, paragrafit 2 të Ligjit nr. 07/1-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës.

Dokumenti përmban pjesën narrative dhe pjesën tabelare, ku janë definuar rezultati, aktivitetet, nën aktivitetet, afati kohor i zbatimit, kostoja e nevojshme për realizim të aktiviteteve, rolet specifike të Institucioneve udhëheqëse dhe mbështetëse si dhe produktet e pritshme pas realizimit të aktiviteteve. Për sqarime të detajizuara të realizimit të aktiviteteve, dokumenti përmban edhe anekset specifike për secilën pjesë.

## 2. QËLLIMI

Qëllimi i hartimit të planit të veprimit për vaksinim të qytetarëve në masë me vaksinën kundër COVID-19 është sigurimi i mbarëvajtjes së procesit të vaksinimit në masë përmes definimit të aktiviteteve të detajzuara, ku parashihet vaksinimi i deri në 500.000 qytetarëve për muaj në tërë territorin e vendit.

Me qëllim të përmbushjes së këtij rezultati dhe mbarëvajtjes sa më të mirë të vaksinimit në masë janë bërë përgatitjet e nevojshme, përfshirë rekrutimin e burimeve njerëzore dhe trajnimin e tyre, funksionalizimin e hapësirave shtesë për vaksinim, shtrirjen e rrjetit qeveritar dhe pajisja e hapësirave me infrastrukturë harduerike, mirëmbajtja e zingjirit të ftohtë, sigurimin e materialeve shpenzuese të nevojshme, asgjësimin e mbetjeve si dhe organizimin e kampanjave me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për përfitimet e vaksinimit.

Rezultat i këtij plani është realizimi i vaksinimit në masë deri në 500.000 qytetarë brenda muajit me vaksinën kundër COVID-19. Me qëllim të arritjes së tij janë specifikuar të gjitha aktivitetet dhe nënaktivitetet, përfshirë edhe detajet e tjera për realizim të tyre.

Procesi i vaksinimit në masë do të ndikoj në zvogëlimin e përhapjes së infeksionit dhe kontrollin e pandemisë si dhe funksionalizimin e aktiviteteve shoqërore, që për synim kanë rikthimin në normalitet.

### 3. METODOLOGJIA

Plani i veprimit për vaksinimin e qytetarëve në masë me vaksinën kundër COVID-19, është hartuar në bazë të kritereve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ 07/2018 për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit.

Në bazë të nenit 17 të Ligjit nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës, në zbatim të Vendimit Nr. 01/11 të datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës së shëndetit publik, është emëruar grupi punues për hartimin e Planit të veprimit për vaksinim të qytetarëve në masë me vaksinën kundër COVID-19.

Dokumenti është hartuar në bazë të të dhënave të siguruara nga Institucionet relevante, duke konsultuar gjithashtu edhe përfaqësues të Institucioneve tjera respektive të përfshira në menaxhim të pandemisë.

Nga të dhënat e siguruara janë identifikuar sfidat të cilat duhet adresuar me qëllim të mbarëvajtjes sa më të mirë të procesit të vaksinimit në masë të qytetarëve në të gjitha lokacionet e përcaktuara të vaksinimit, përfshirë edhe të gjitha ato shtesë.

Plani i veprimit do të zbatohet për periudhën e ardhshme gjashtë mujore (15.06.2021-31.12.2021), përderisa projeksionet e tjera do të bëhen varësisht nga situata epidemiologjike ku do të pasqyrohen projeksionet për periudhën e ardhshme për vitin 2022.

### 4. SFONDI

Në zbatim të Planit Shtetëror të vaksinimit kundër COVID-19, si shumë vende tjera, edhe Republika e Kosovës me datë 29 mars të vitit 2021 ka filluar vaksinimin kundër COVID-19, duke filluar me fazën e parë - vaksinimin e profesionistëve shëndetësorë dhe qytetarëve të moshës mbi 80 vjeçare (i aprovuar me datë 18.02.2021 dhe i publikuar në web faqen zyrtare të MSh).

Vaksinimi ka vazhduar në 6 regjione të tjera me vaksinim të profesionistëve shëndetësor duke vazhduar vaksinimi mëpastaj edhe në 29 komuna të tjera të vendit, vaksinimin e të moshuarve të vendosur në shtëpitë e kujdesit për të moshuar dhe punëtorët socialë që kujdesen për ta, në komunat ku ka qendra të tilla si Prishtinë, Suharekë, Skënderaj, Istog dhe Graçanicë, për të vazhduar me pacientët në dializë sipas komunave përkatëse. Planifikimi dhe përcaktimet e termineve të vaksinimit janë bërë bazuar në dozat e vaksinave të cilat kanë qenë në dispozicion.

#### 4.1. Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore

Kapacitetet njerëzore me fillimin e vaksinimit kanë qenë gjithsej 89 ekipe (89 mjek dhe 178 infermierë). Ekipet janë mbështetur nga vullnetarët e Kryqit të Kuq të Kosovës dhe UNICEF. Me fillimin e vaksinimit në masë, janë përcaktuar gjithsej 279 ekipe për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

Përcaktimi i numrit të ekipeve është bazuar në numrin e popullsisë dhe përqindjes së mbulueshmërisë sipas projeksioneve me dozat e mundshme në dispozicion. Për të mbuluar administrimin e 350 mijë vaksinave në muaj, qendra e vaksinimit duhet të punojnë 13 orë në ditë, duke alternuar 2 ndërrime (me nga 6 orë e gjysmë punë për ndërrim pa ndërprerë). Parashihet që një ekip të vaksinon 8 qytetarë në orë (me nga 7.5 minuta diferencë), kurse për administrimin e 500.000 vaksinave në muaj, ekipi vaksinon 12 qytetarë në orë (me 5 minuta diferencë). Varësisht nga numri i dozave në dispozicion mund të rritet/zvogëlohet diferenca kohore për administrimin e vaksinës dhe mund të shtohet numri i ditëve të punës (të punohet edhe në fund javë dhe festa). Te këto kalkulime të ekipeve është paraparë të përkrahet edhe vaksinimi me ekipe mobile (sipas nevojës). Po ashtu janë paraparë të rekrutohen edhe infermierë me përvojë të avansuar në IT, për të përkrahur koordinatorët e SISh dhe ekipet mjekësore në përdorimin e modulit të vaksinimit dhe procesit të vaksinimit në përgjithësi (në rast të pamundësisë së prezencës në punë të ndonjë profesionisti shëndetësor gjatë procesit). Për ekipet mobile në nivel vendi janë paraparë të sigurohen 70 laptop, printer portable dhe mbushje telefoni për lidhje në internet.

Kurse sa i përket angazhimit të stafit mjekësor, është planifikuar angazhimi i 190 specialistëve dhe rekrutimi i 422 infermierëve për mbështetje të procesit të vaksinimit kundër COVID-19 (Shtojcë 1 – Matrica për administrimin e 350 – 500 mijë doza në muaj) . Përpilimi i planit për angazhimin e specialistëve do të bëhet në bazë të regjioneve varësisht prej ekipeve shtesë që janë paraparë në komunën përkatëse (Shtojcë 2 – Lista e specialistëve sipas komunave dhe Shtojcë 3 - Infermierët shtesë për procesin e vaksinimit në masë).

Stafi i angazhuar në proces të vaksinimit do të trajnohet për administrimin e vaksinës kundër COVID-19, me mbështetjen e Bankës Botërore. MSh ka kërkuar nga të gjitha komunat të definojnë numrin e vullnetarëve të nevojshëm për angazhim gjatë procesit të vaksinimit në masë, të cilët do të mbështeten nga KKK dhe UNICEF (Shtojcë 4 - detyrat dhe përgjegjësitë e punës së vullnetarëve).

#### 4.2. Hapësirat për vaksinimin e popullatës

Nga komunat është kërkuar identifikimi i hapësirave të përshtatshme për vaksinimin e qytetarëve në masë. (Shtojcë 5 – Hapësirat për vaksinim në masë)

Në nivelin lokal të gjitha komunat kanë treguar përkushtim dhe bashkëpunim në përcaktimin e lokacioneve të përshtatshme për vaksinim.

Lokacionet e përcaktuara duhet të plotësojnë kushtet minimale si në vijim:

- Qasjen e pandërprerë të enegjisë elektrike
- Prezencën e ekipës urgjente në njësinë e vaksinimit gjatë gjithë orarit të punës
- Sigurimin e frigoriferit statik 2-8 gradë celcius
- Sigurimin e kushteve të mjaftueshme (hyrje-dalje) për personat me aftësi të kufizuara
- Sigurimin e karrigeve dhe tavolinave për ekipet e vaksinimit
- Sigurimin e librit të protokolit
- Sigurimin e materialit shpenzues (laps kimik, notes, makinë për ngjitjen e letrës, municon për ngjitjen e letrës dhe material tjetër i nevojshëm për punë)
- Sigurimin e dezinfektimit të hapësirave të vaksinimit
- Sigurimin e menaxhimit për asgjësimin e mbetjeve mjekësore
- Sigurimin e qeseve të verdha (biohazard)
- Standardizimi i rrjedhës së procesit të vaksinimit unik për të gjitha komunat (Ankes 6 – Flowchart i rrjedhës së procesit)
- Sigurimin e materialit higjienik
- Sigurimi i mirëmbajtjes së hapësirave për nevoja fiziologjike.

Nga udhëheqësit e QKMF-ve të të gjitha komunave është kërkuar që të sigurojnë kushtet e lartpërmendura për mbarëvajtjen e procesit të vaksinimit në masë (Shtojcë 7 – matrica me përgjigjet nga komunat).

Organizimi i hapësirës në të gjitha njësitë e vaksinimit do të mundësohet përmes shiritave ndarës dhe paravanëve të cilët do të sigurohen nga donatorët.

MSh ka pranuar listën e kompletuar me hapësirat e reja dhe ka kontaktuar ASHI/MPB për të funksionalizuar këto lokacione me rrjetin qeveritar. Gjithashtu, MSh do të funksionalizojë këto qendra me pajisje harduerike (zero client, maus, tastaturë printer) dhe letër A6 për printimin e kartelës së vaksinimit. MSh për nevojat e ekipeve mobile do të siguroj lllaptop, printer portable



dhe mbushje të telefonit për internet për përdorimin e modulit të vaksinimit. Do të sigurohen materialet administrative të printuara, si deklaratën e pëlqimit, formularin e anamnezës, informacionin, përmbledhjen e vaksinës për numrin përkatës të dozave për secilën komunë (Shtojcë 8 – Dokumentacionet e vaksinimit).

#### **4.3. Mjetet mbrojtëse kundër COVID-19**

Në kuadër të mbrojtjes kundër COVID-19 komunat obligohen të realizojnë dezinfektimin e rregullt të hapësirave të vaksinimit (minimum një herë në ditë, në fund të orarit të punës). Ndërsa, MSh përmes furnizimeve të rregullta të ISH të KPSH do të vazhdojë të sigurojë mjetet e nevojshme mbrojtëse PPM. Këto mjete MSh do t'i sigurojë përmes blerjeve dhe me mbështetje eventuale të partnerëve strategjik. MSh do të sigurojë edhe veshjet mbrojtëse një-përdorimëshe për vullnetarët e angazhuar në qendrat e vaksinimit.

#### **4.4. Materialet shpenzuese për administrimin e vaksinës**

Për administrimin në kohë të vaksinave për njësitë e vaksinimit do të sigurohen materialet e nevojshme shpenzuese përfshirë: shiringat VLDE 0.3 ml për administrimin e vaksinave, gjilpëra 21G (për tretje) dhe 23G (për administrim), tretësit e vaksinave nga 2 ml për vaksinë si dhe shiringat për tretje 2.5 ml dhe materialet tjera përcjellëse (alkooli 70%, filaster, tupfer pambuku, etj.).

#### **4.5. Menaxhimi i zinxhirit të ftohtë**

MSh/IKShPK është i pajisur me dy dhoma ftohëse me temperaturë 2 - 8 gradë celcius, një dhomë ngrirëse me temperaturë -20 gradë celcius dhe shtatë frigorifer me kapacitet 600 L ultra të ftohtë (prej -70 deri në -90 gradë celcius). Si mbështetje e ekipit aktual të IKShPK për menaxhimin dhe ruajtjen e zinxhirit të ftohtë prej momentit të pranimit deri në distribuimin e vaksinave, është planifikuar të angazhohen 2 infermierë shtesë të cilët do të jenë pjesë e rekrutimit të grupit prej 422 infermierëve. Në nivel vendi, në dispozicion janë 1344 frigorifer të dorës si dhe 300 termometër për monitorimin e vazhdueshëm të temperaturës, të cilat janë në përdorim nga ekipet mjekësore. Për mirëmbajtje të zinxhirit të ftohtë, të gjitha njësitë e reja për vaksinimin në masë duhet të kenë në dispozicion frigoriferin statik 2-8 gradë celcius për ruajtjen e vaksinave brenda një orari të punës.

#### **4.6. Menaxhimi i mbetjeve mjekësore**

Sa i përket menaxhimit të mbetjeve nga vaksinimi kërkohet vëmendje e veçantë! Ligji për Produktet dhe Pajisjet Mjekësore Nr. 04/1-190 dhe Udhëzimi Administrativ për trajtimin e

mbeturinave të produkteve mjekësore nr. 10/2015 rregullon çështjen e menaxhimit të mbetjeve mjekësore. Klasifikimi i mbetjeve bëhet përmes kutive të sigurisë (safety box) dhe qeseve të verdha (biohazard) të cilat pastaj asgjësohen sipas praktikave të deri tanishme.

#### 4.7. Moduli i vaksinimit

MSh në bashkëpunim me ASHI kanë ofruar mundësinë e aplikimit online për vaksinim përmes platformës eKosova. MSh ka digjitalizuar procesin e vaksinimit përmes krijimit të modulit të vaksinimit kundër Covid 19 tek i cili identifikohet qytetari, detajet e vaksinës së administruar dhe ekipi mjekësor i cili ka administruar vaksinën. Pas këtij procesi qytetarit i printohet kartela digjitale me të dhëna të plotësuara e cila është e verifikueshme përmes QR code.

Për të mundësuar vaksinimin e qytetarëve në masë dhe për të evituar grumbullimin e qytetarëve është krijuar mundësia e caktimit të termineve përmes 2 opsioneve:

- Caktimi i terminit online përmes eKosova nga vetë qytetari (dhe nga qytetari për qytetarët tjerë, për max pesë persona)
- Caktimi i terminit në insitucionet e KPSH përmes BHIS (aplikacionit të SISh) të cilat e kanë këtë sistem të implementuar.

Varësisht nga numri i ekipeve, dozave dhe orarit të punës, mundësohet sllotimi për të ofruar terminet e lira për vaksinim. Kjo nënkupton që me zvogëlimin e slloteve të lira, rritet numri i të vaksinuarve dhe anasjelltas. Në momentin e shtimit të dozave rritet edhe numri i slloteve. Për të parë në kohë reale të dhënat mbi numrin e të vaskinuarve sipas gjinisë, komunës, profesionit, grup moshës, është krijuar një Dash Board (pult) që shfaq këto të dhëna.

#### 4.8. Kampanjat për ngritjen e vetëdijes së popullatës për vaksinim kundër COVID-19

Përmes komunikimit me publikun synohet ngritja e vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e vaksinimit. Të kuptuarit e drejtë të informatave lidhur me vaksinimin nga të gjitha palët e interesit, mundëson ngritjen e nivelit të njohurive të përgjithshme dhe ndërtimin e një besimi, i cili lehtëson zbatimin e këtij plani në nivel vendi. Komunikimi i koordinuar dhe efektiv midis të gjitha niveleve të kujdesit shëndetësor, ndihmon në shmangien e keqinformimeve lidhur me vaksinimin, si dhe inkurajimin e qytetarëve për t'u vaksinuar.

Përmes komunikimit të koordinuar synohen audiencat lokale, të cilat kanë më pak njohuri për përfitimet e vaksinimit. Vetëdijësimi i popullatës për rëndësinë e vaksinimit do të bëhet në vazhdimësi përmes kampanjave të vetëdijësimit, rrjeteve sociale, infografive, video mesazheve motivuese, broshurave si dhe angazhimi i profesionistëve shëndetësorë dhe personave me ndikim për inkurajim të qytetarëve për vaksinim me vaksinën kundër COVID - 19.

#### **4.9. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional**

Aspekt i rëndësishëm i mbarëvajtjes së procesit të vaksinimit kundër COVID-19 është edhe komunikimi, koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të nivelit qendror dhe atij lokal.

Si mekanizëm përgjegjës për këtë proces në secilën komunë janë emëruar ekipet në përbërje të udhëheqësit të njësisë së vaksinimit, koordinatori i SISh-it dhe koordinatorit të cilësisë të cilët janë pjesë e ekipës menaxhuese në nivel vendi, të cilët duhet të koordinojnë dhe raportojnë për procesin dhe nevojat e vaksinimit në MSh dhe Komitetit për imunizim të popullatës me vaksinën COVID-19. (Shtojcë 9 - Kontaktet e udhëheqësit të njësisë së vaksinimit, koordinatori i SISh-it dhe koordinatorit të cilësisë të secilës komunë)

## **5. MONITORIMI DHE RAPORTIMI**

Institucioni udhëheqës për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit është Ministria e Shëndetësisë. Me qëllim të monitorimit të zbatimit të planit, janë hartuar matricat e monitorimit dhe raportimit për indikatorët e përcaktuar.

Korniza e monitorimit përmbanë rezultatin, aktivitetin, indikatorin, bazën, cakun, mbledhjen e të dhënave si dhe gjendjen aktuale. (Shtojcë 10 – Matricat e raportimit)

## **6. NDIKIMI BUXHETOR I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT**

Plani i veprimit për vaksinim të qytetarëve në masë me vaksinën kundër COVID-19 nuk krijon kosto shtesë buxhetore, duke nënkuptuar se të gjitha aktivitetet e parpara me këtë plan do të mbulohen nga ndarjet buxhetore të parpara me Ligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, respektivisht nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike që janë ndarë për Ministrinë e Shëndetësisë për menaxhimin e pandemisë COVID-19.

Një pjesë e aktiviteteve të këtij plani do të financohen edhe nga donatorët siç janë Organizata Botërore e Shëndetësisë, UNICEF me shumë prej 322,420 €.

**Plani i veprimit për vaksinim të qytetarëve në masë me vaksinën kundër COVID 19**

**Rezultati 1**

**Vaksinimi në masë, deri në 500.000 qytetarë të vaksinuar brenda muajit me vaksinën kundër COVID 19**

Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Instucioni udhëheqës	Instucioni mbështetës	Produkti
<b>1.1 Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore</b>	<b>Q2-Q4</b>	<b>0</b>	<b>Buxheti i Kosovës</b>	<b>MSh</b>	<b>MSh</b>	<b>Kapacitetet njerëzore të fuqizuara</b>
<b>Nënaktivitetet</b>						
1.1.1 Përcaktimi i numrit të ekipve të vaksinimit	Q2-Q4	0	Buxheti i Kosovës	MSh	MSh, Komiteti, Ekipi menaxhues	279 ekipe të aktivizuar në procesin e vaksinimit
1.1.2 Angazhimi i Specializantëve për mbështetje të procesit të vaksinimit kundër COVID 19	Q2-Q4	0	Buxheti i Kosovës	MSh	Bordi Qendror për shkollim Specialistik	190 Specializantë të angazhuar për mbështetje të procesit të vaksinimit kundër COVID 19
1.1.3 Rekrutimi i infermierëve për mbështetje të procesit të vaksinimit kundër Covid19	Q2-Q4	422x448.35x7 muaj 1,324,425.90 €	Buxheti i Kosovës	Administrata MSh	MSh	422 infermierë të rekrutuar për mbështetje të procesit të vaksinimit kundër COVID 19  (10 infermierë shtesë)
1.1.4 Angazhimi i vullnetarëve në mbështetje të procesit të vaksinimit	Q2-Q4	0	0	UNICEF, Kryqi i Kuq i Kosovës	MSh	200 vullnetar të siguruar në mbështetje të procesit të vaksinimit
1.1.5 Trajnimi i mjekëve në administrimin e vaksinave	Q2-Q4	Kosto Administrative	BB	MSh	IKShPK ,OBSh, BB, UNICEF	190 Mjekë shtesë të trajnuar në administrimin e

kundër COVID 19						vaksinave kundër COVID 19
1.1.6 Trajnimi i infermierëve në administrimin e vaksinave kundër COVID 19	Q2-Q4	Kosto administrative	BB	MSh	IKShPK, OBSH, BB, UNIEF	422 Infermierë shtesë të trajnuar në administrimin e vaksinave kundër COVID 19
1.1.7 Trajnimi i ekipeve për vaksinim në përdorimin e modulit të vaksinimit	Q2-Q4	Kosto administrative	Brenda Buxhetit	MSh/DSISH	MSh	89 ekipe të trajnuara për përdorimin e modulit të vaksinimit
1.1.8 Identifikimi i ekipit menaxhues nëpër qendrat e vaksinimit	Q2-Q4	Brenda Buxhetit	Brenda Buxhetit	Komunat , MSh	MSh	29 ekipe (një ekip në secilën komunë) të siguruar për mbikqyrje të procesit të vaksinimit.  Lista me të dhënat kontaktuese të ekipeve të secilës komunë e siguruar
<b>Aktiviteti</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Kostoja totale</b>	<b>Burimi i financimit</b>	<b>Instucioni udhëheqës</b>	<b>Instucioni mbështetës</b>	<b>Produkti</b>
1.2 Funkcionalizimi i hapësirave për vaksinimin e popullatës	Q2-Q4	0	0	Komunat	MSh	Hapësirat për vaksinimin e popullatës të funksionalizuara
<b>Nënaktivitetet</b>						
1.2.1 Identifikimi i hapësirave të përshtatshme për vaksinimin në masë	Q2	0	0	Institucionet e KPSH	MSh	Lista e përpiluar e lokacioneve të reja për vaksinimin në masë, nga të gjitha komunat

1.2.2 Përshtatja e hapësirave të punës për ekipet e vaksinimit në qendrat e vaksinimit	Q2	Inventari ekzistues në komuna	Inventari ekzistues në komuna	Institucionet e KPSH	Komunat	Tavolinat për ekipet e vaksinimit të siguruara nga Komunat  Karriget për ekipet e vaksinimit të siguruara nga Komunat
1.2.3 Sigurimi i furnizimit me 20 Libër të protokolit	Q2-Q4	2,000.00€	Brenda Buxhetit	Institucionet e KPSH	MSh	Librat e protokolit të siguruara nga Komunat  20 Libra te protokolit te siguruara nga MSh
1.2.4 Sigurimi i materialit shpenzues për nevojat e ekipeve (Folldera (dosje) A4 80 gr, Fasiklla tejdukshme A4, Kartela A6 të vaksinimit, Përmbledhje, Anamneza, Informacioni (fotokopje) Letër ris A4, Fasiklla kartoni me lidhse A4, Laps Kimik i kaltërt, Marker nënvizues, Marker përmanent i zi për fllakona, Marker permanent i zi, Makin hefti standard, Municion per makin hefti 24/6	Q2	Total 219,261.80 €  MSh 204,241.80€ Kontrata Aktive  BB 15,020.00 €	Brenda Buxhetit  BB	MSh , BB	Komunat	Materiali shpenzues i siguruar  BB: Letër për duar: 9000€ (300 pako me nga 4 copë);  Gotë plastike 5040€ (6300 pako me nga 100 copë);  Qese të zeza 980 € (1000 pako me nga 100 copë) = 15,020 €

1x1000, Çkapse për municion heftit, Makin per shpurje te letres, Aero ngjitës i vogel, Aero ngjitës i madh, Gershër, Kapse metali 28mm 1x50 (për kartele), Leter per duar, Gote plastike, Qese te zeza )						
1.2.5 Sigurimi i 17,625,123 fletëve A4 të printuara	Q2-Q4	155.000 € Administrata MSh Brenda buxhetit	MSh 155.000€	MSh	UNICEF	17,625,123 fletë A4 të printuara (9 faqe = Deklarata të pëqimit+ formular të anamnezës+ informacioni +përmbledhje e vaksinë të siguruara)  15,375,123 fletë A4 të printuara nga MSh  2,250.000 A4fletë të printuara nga UNICEF
1.2.6 Sigurimi i letrës A6 për printimin e kartelës elektronike	Q2-Q4	24,000.00 € Kontratë valide	Brenda buxhetit	MSh	MSh	2.1 Milion letër A6 të siguruar për printim të kartelës elektronike
1.2.7 Sigurimi i 100 shiritave të kuq ndarës për të gjitha	Q2	7,000.00 €	UNICEF	MSh	UNICEF	100 shirita ndarës të siguruar për të gjitha lokacionet e vaksinimit



lokacionet e vaksinimit						
1.2.8 Sigurimi i 180 Paravanëve për të gjitha lokacionet e vaksinimit	Q2	14,400.00 €	UNICEF	MSh	UNICEF	180 Paravanë të siguruar për të gjitha lokacionet e vaksinimit
1.2.9 Shtrirja e rrjetit qeveritar nëpër qendrat e vaksinimit	Q2	Brenda Buxhetit	Buxheti i Kosovës	AShI	Msh	Rrjeti qeveritar funksional në të gjitha lokacionet e reja për vaksinimin në masë
1.2.10 Sigurimi i 279 zero klientëve, 279 tastatura, 279 maus për të gjitha lokacionet.	Q2	Brenda buxhetit	Buxheti i Kosovës	MSh	MSh	279 zero klient, 279 tastatura dhe 279 mausë për të gjitha lokacione e reja të vaksinimit të siguruara
1.2.11 Sigurimi i pajisjes me printer	Q2	29,760.00 € Brenda Buxhetit	Buxheti i Kosovës	MSh	MSh	60 printer të siguruar për lokacionet e reja për vaksinimin në masë në të gjitha komunat
1.2.12 Pajisja me printer për printim të stikerave	Q2	27,316.00 €	UNOPS (kredi)	MSh	MSh	40 pajisje me printer për printim të stikerave
1.2.13 Pajisja me printer portabile dhe toner për ekipet mobile	Q2	4,500.00 €	UNICEF	MSh	UNICEF	30 printer portabël dhe toner të siguruar për ekipet mobile
1.2.14 Pajisja me 70 laptop ekupe mobile	Q2	35,000.00 €	UNICEF	MSh	UNICEF	70 laptop të siguruar për ekipet e vaksinimit
1.2.15 Sigurimi i 60 Switch për të gjitha lokacionet e vaksinimit	Q2	1,500.00 €	UNICEF		UNICEF	60 Switch të siguruara për të gjitha lokacionet

1.2.16 Sigurimi i 20 box Cat 6A kablo (300 m) për të gjitha lokacionet e vaksinimit	Q2	2,360.00 €	UNICEF	MSh	UNICEF	20 box Cat 6A kablo (300 m) për të gjitha lokacionet e vaksinimit të siguruara
1.2.17 Sigurimi i mbushjeve të telefonit për hotspot për ekipet mobile për përdorimin e modulit të vaksinimit	Q2-Q4	2,450.00 €	UNICEF	MSh	UNICEF	Mbushjet e telefonit të siguruara për 70 ekipe mobile. (70 x 5€ x7 muaj)
1.2.18 Dërgimi i SMS-ve për termine	Q2-Q4	10,000.00 €	MSh Brenda Buxhetit	MSh	MSh	2,000,000 SMS të dërguar tek qytetarët për termine
1.2.19 Sigurimi i 282 Banerëve për të gjitha njësitë e vaksinimit	Q2	16,920.00 €	BB	MSh		282 Banerë të siguruara për të gjitha njësitë e vaksinimit (përfshirë dizajnimin, printimin, shpërndarjen dhe montimin në Qendra të vaksinimit)
1.2.20 Sigurimi i 420 shënjimeve sipas flowchart për të gjitha njësitë e vaksinimit	Q2	25,000.00 €	BB	MSh		420 shënjime të siguruara për gjitha njësitë e vaksinimit (përfshirë dizajnimin, printimin, shpërndarjen dhe montimin në qendra të vaksinimit)
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Instucioni udhëheqës	Instucioni mbështetës	Produkti

<b>1.3</b>	<b>Q2-Q4</b>		<b>Buxheti i Kosovës</b>	<b>Institucionet e KPSH</b>	<b>Komunat</b>	<b>Mjetet mbrojtëse kundër covid 19 të siguruar</b>
<b>Nënaktivitetet</b>						
1.3.1 Sigurimi i dezinfektimit të qendrave të vaksinimit	Q2-Q4	Brenda buxhetit	Brenda buxhetit	Institucionet e KPSH	Komunat	Resurset ekzistuese MAP dhe Komunat
1.3.2 Sigurimi i mjeteve mbrojtëse kundër Covid19 (PPM)	Q2-Q4	145,000.00 €	BB	BB	MSh, Komunat	PPM të siguruar në stokun e MSh/DQ dhe donatorët
1.3.3 Sigurimi i alkoolit 70% për qendrat e vaksinimit	Q2-Q4	39,000.00 €	BB	MSh	MSh	10000 litra alkool 70% nga BB 6000 litra alkool 70% të siguruar nga DQ e MSh-së (për KPSH)
<b>Aktivitetet</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Kosotoja totale</b>	<b>Burimi i financimit</b>	<b>Instucioni udhëheqës</b>	<b>Institucioni mbështetës</b>	<b>Produkti</b>
1.4 Sigurimi i materialeve shpenzuese për vaksinim	Q2-Q4	0		MSh	MSh	Materialet shpenzuese për vaksinim të siguruar
<b>Nënaktivitetet</b>						
1.4.1 Sigurimi i 1,295,000 shiringave / 0.3ml VLDE me gjilpërë për 23 G	Q2-Q4	110.000 €	MSh	MSh	MSh, UNICEF	Numri total prej 1,295,000 shiringa 0.3 ml VLDE me gjilpërë VLDE me gjilpërë për 23 G të siguruar për gjithë furnizimin deri në fund të vitit 1.5 milion shiringa (afro 140.000 €)

1.4.2 Sigurimi i 220,458 shiringave për tretje 2.5 ml, me gjilpërë 21G	Q2-Q4	1.867.000 €	MSh Brenda buxhetit	MSh	MSh, UNICEF	220,458 shiringa të siguruara në stokun e MSh për tretje 2.5 ml me gjilpërë 21 G për furnizim deri në fund të vitit
1.4.3 Sigurimi i 220,458 tretësve nga minimum 2 ml për vaksinë	Q2-Q4	33,068.7€	MSh Brenda buxhetit	MSh	MSh	200,000 copë të tretësve 5ml të siguruara për furnizim deri në fund të vitit
1.4.4 Sigurimi i 2,000,000 copë të flasterëve me diameter 25mm (100,000 kuti - pack of 20)	Q2-Q4	30,000.00 €	BB	MSh	MSh	2,000, 000 flasterë të siguar për furnizim deri në fund të vitit
1.4.5 Sigurimi i 8000 pako të tubferëve të pambukut (minimum 500gr)	Q2-Q4	10,720.00€	BB	MSh	MSh	8000 pako të tubferëve siguruara deri në fund të vitit
1.4.6 Sigurimi i materialit higjienik per qendrat e vaksinimit	Q2-Q4	5,580.00 €	UNICEF	KPSH	UNICEF (2 muaj) Komunat	Letër higjienike, shampo për duar të siguruara nga komunat dhe donatorët potencial
<b>Aktiviteti</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Kostoja totale</b>	<b>Burimi i financimit</b>	<b>Instucioni udhëheqës</b>	<b>Instucioni mbështetës</b>	<b>Produkti</b>
<b>1.5 Menaxhimi i ruajtjes së zinxhirit të ftohtë</b>	Q2-Q4	Brenda buxhetit	MSh	MSh/IKShPK	MSh	2 inferimerë të rekrutuar për menaxhimin e zinxhirit të ftohtë
<b>Nënaktivitetet</b>						
1.5.1 Mirëmbajtja e zinxhirit të ftohtë gjatë transportit të	Q2-Q4	Brenda buxhetit	UNICEF	IKShPK/KPSH	UNICEF	1344 frigoferëve të dorës+ patronëve te akullit të siguar, 300

vaksinave nëpër komuna						termometër të siguruar
1.5.2 Sigurimi i frigoriferëve kryesor në njësitë gjatë vaksinimit	Q2-Q4	Brenda buxhetit	UNICEF	Përgjegjësit e njësive të imunizimit në KPSH	MSh/IKSHPK	Zinxhiri i ftohtë funksional sipas standardeve të përcaktuara
<b>Aktiviteti</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Kostoja totale</b>	<b>Burimi i financimit</b>	<b>Instucioni udhëheqës</b>	<b>Instucioni mbështetës</b>	<b>Produkti</b>
1.6 Kampanjat për ngritjen e vetëdijes së popullatës për vaksinim kundër COVID 19	Q2-Q4		UNICEF	MSh	MSh, UNICEF	Kampanjat për vetëdijësim të realizuara
<b>Nënaktivitetet</b>						
1.6.1 Targetimi dhe angazhimi i punëtorëve shëndetësor me qëllim të inkurajimit të qytetarëve për vaksinim	Q2-Q4	10,000.00 €	UNICEF	IKSHPK	MSh, SHSKUK-KPSH, AQH, UNICEF, OBSH, UNFPA	Takimet me punëtorët shëndetësor të mbajtura në grupe të vogla dhe të mëdha të realizuara me qëllim të vaksinimit  Informimi ë qytetarëve nga ekspertët shëndetësor për rëndësinë e vaksinimit i realizuar  Bërja publike e aktit të vaksinimit (kartela e vaksinimit, foto, postime në rrejte sociale, intervista në media, rrëfime personale të mjekëve për benefitet e vaksinimit)
1.6.2 Angazhimi i influencuesve për të ndikuar	Q2-Q4	10,000.00 €	MSh /BB (PShK)			Ndikues në publik të angazhuar

në vaksinimin, për grupet e marginalizuara dhe komunitetin e hezituesve ndaj vaksinës COVID-19				MSh	UNICEF, BB, OBSH	Mesazhe për benefitet e vaksinimit nga persona me ndikim publik të realizuara, video-mesazhe nga kampionët e vaksinimit, postime në rrjetet sociale, kolumne në media, intervista në mediat kryesore në prime-time
1.6.3 Targetimi i publikut të gjerë	Q2-Q4	25,000.00 €	MSh/BB (PShK)/UNICEF			<p>Popullata e informuar për rëndësinë e vaksinimit nga profesionistët dhe ekspertët shëndetësor, zëdhënësit e institucioneve, përfaqësues të komuniteteve të marginalizuara, mesazhe kyçe të shpërndara në popullatë përmes mediave dhe rrjeteve sociale</p> <p>FAQ të krijuara për të adresuar pyetjet dhe shqetësimet e qytetarëve, rrëfime nga qytetarët e vaksinuar, infografika të punuara me të dhëna të bazuara në dëshmi, radio dhe video-mesazhe të plasuara në media dhe rrjete sociale; hulumtime rreth perceptimeve për vaksinën; publikime të rregullta të dhënave rreth vaksinimit; forume</p>

						informuese me kategori të caktuara
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Instucioni udhëheqës	Instucioni mbështetës	Produkti
1.7 Menaxhimi i mbetjeve mjekësore	Q2-Q4	0	Komunat	Komunat	Komunat Donatorët	Menaxhimi i mbetjeve mjekësore funksional
<b>Nënaktivitetet</b>						
1.7.1 Grumbullimi i mbetjeve në boxet e sigurisë (safety box)	Q2-Q4	Kosto administrative	BB	Ekipet e vaksinimit	Komunat e RKS	Mbetjet e grumbulluara në mënyrë të sigurtë
1.7.2 Sigurimi i 25,000 cope safety box me kapacitet 5L (1000 paketime me nga 25 safety box) për hudhjen e mbetjeve mjekësore	Q2-Q4	9,260.00€	BB	MSh	BB	25,000 Safety Box te siguruara. (1000 paketime me nga 25 safety box)
1.7.3 Grumbullimi i mbetjeve në qese	Q2-Q4	Kosto administrative	Komunat. BB	Ekipet e vaksinimit	Komunat e RKS	Mbetjet e grumbulluara në qese
1.7.4 Sigurimi i 63,000 cope qeseve te verdha (biohazard)për hudhjen e mbetjeve	Q2-Q4	31,500.00 €	BB	MSh	BB	63,000 copë qese të verdha (biohazard)të siguruara.
1.7.5 Asgjësimi i mbetjeve sipas legjislacionit në fuqi	Q2-Q4	Kosto administrative	Buxheti i Kosovës	Komunat e RKS	MSh, MAE	Mbetjet e asgjësuar sipas legjislacionit në fuqi
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Instucioni udhëheqës	Instucioni mbështetës	Produkti
1.8 Funkcionalizimi i Modulit të vaksinimit	Q2-Q4	0	UNICEF	MSh	UNICEF	Moduli i vaksinimit i funksionalizuar
<b>Nënaktivitetet</b>						

1.8.1 Digjitalizimi i procesit të vaksinimit	Q1-Q4	10,000.00 €	UNICEF	MSh	UNICEF	Moduli i vaksinimit kundër covid19 i digjitalizuar dhe funksional
1.8.2 Hartimi i raporteve monitoruese	Q1-Q4	0	UNICEF	MSh	UNICEF	Raportet monitoruese të hartuara
1.8.3 Caktimi online i termineve përmes B HIS	Q1-Q4	10,000.00 €	UNICEF	MSh	UNICEF	Terminet online përmes B- HIS të funktionalizuara
1.8.4 Catimi online i termineve përmes e Kosova	Q2-Q4	10,000.00 €	UNICEF, ASHI (e Kosova)	MSh	UNICEF, ASHI	Termine online përmes e-Kosova të të funksionalizuara
1.8.5 Krijimi i Dash Board për shfaqje në kohë reale të statistikave të vaksinimit	Q2-Q4	Donacion		MSh		Dash Board funktional me të dhëna në kohë reale me statistikave e vaksinimit